



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Thirrje për

**Shoqatat, OJQ-të kulturore, rinore, Klubet sportive, për organizimin e aktiviteteve
Kulturore, Rinore dhe Sportive në Komunën e Podujevës**

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: 04.09.2020

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 18.09.2020

Përmbajtja

1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E KLUBEVE, OJQ-VE, SHOQATAVE, INDIVIDËVE NË FUSHËN E RINISË DHE SPORTIT	
1.1 PROBLEMET TË CIALAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE.....	
1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE	
1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES	
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES	
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?	
2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit	
2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes	
2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes	
2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme	
2.4.2 Shpenzimet e papranueshme	
3. SI TË APLIKONI?	
3.1 Forma e përshkruese e projektpropozimit.....	
3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit.....	
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?	
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve.....	
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?	
4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE	
4.1 Aplikacionet e pranura do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:	
4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi.....	
5. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE	

1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E KLUBEVE, OJQ-ve, SHOQATAVE, INDIVIDËVE, NË FUSHAT RINORE DHE KULTURORE, ORGANIZIME, EDUKIM JOFORMAL, PROMOVIMI I VULLNETARIZMIT, INTEGRIMI I GRUPEVE RINORE, SEMINAR, TRAJNIME.

1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHEN TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Komuna e Podujevës kujdeset për jetën kulturore ,rinore dhe sportive.

Me këtë synim Komuna e Podujevës ofron përkrahje për organizim kulturor, OJQ-të rinore, klube dhe shoqata sportive si dhe individë me aftësi të posaçme kreative, në fushën e rinisë, kulturës dhe sportit .

Në këtë vijë, Komuna e Podujevës synon pasurimin e jetës rinore, kulturore dhe sportive të qytetit, rritjen e llojllojshmërisë së aktiviteteve, tërheqjen e numrit sa më të madh të publikut në aktivitete . Komuna po ashtu ka për synim ngritjen e cilësisë së programeve.

1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objekti/objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje është që Komuna e Podujevës ofron përkrahje për Aktivitetet kulturore, Shoqata, OJQ-të, Klubet Sportive, dhe mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi. Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore – rinore dhe sportive.

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë:

Të gjitha Klubet, Shoqatat, OJQ-të kulturore-rinore, që veprojnë në Komunën e Podujevës.

1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES

1. Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej 40,000oo €.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. Të gjithë OJQ-të aplikuese që janë të regjistruara në Komunën e Podujevës .
2. Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit;
3. OJQ-të, shoqatat, Klubet të cilët veprimtaria e tyre është e fokusuar në fushën e kulturës ,rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës;
4. Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
5. Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
6. Të gjithë aplikuesit që i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Podujevës

2.2. Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrje:

1. Të gjithë aplikuesit që nuk i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Podujevës,
2. OJQ-të ,Klubet Shoqatat e falimentuara,
3. Klubet, OJQ-të, të cilat mund të kenë konflikt interesi.

3. Një aplikant mund të paraqesë vetëm një kërkesë për aplikim.

2.3 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit

1. Aplikanti duhet të veprojnë në partneritet me të paktën një OJQ, e cila ushtron aktivitetin në Komunën e Podujevës.
2. Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë që zbatohet për aplikuesit, si në pikën e specifikuar në pikën 2.1, të këtyre udhëzimeve.
3. Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere. Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit, e cila duhet të dorëzohet një kopje origjinale të nënshkruar nga secili partner në projekt.

2.4 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

1. Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve deri më 31.12.2020.
2. Aktivitetet e projektit duhet të kryhen brenda lokacionit të Komunës së Podujevës.
3. Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:
 1. Kërkesat nga OJQ-të kulturore, rinore, sportive, shoqatat.
4. Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:
 1. Aktivitete që nuk zhvillohen në Komunën e Podujevës;
 2. Aktivitete që përmbajnë diskriminim gjinor;
 3. Aktivitete që përmbajnë diskriminim fetar;

2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime.

2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Shpenzimet rreth organizimit i aktiviteteve;
2. Material shpenzues;
3. Sigurimi i sallave, shpenzimet e zërimit, ndriçimit;
4. Transporti
5. Pjesëmarrjen në gara vendore, ndërkombëtare, pjesëmarrje në turne,
6. Shërbime grafike (shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, duke specifikuar llojin e qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj;)
7. Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit.

2.4.2. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

1. Udhëtime jashtë agjendës së programeve;
2. Renovime;
3. Dhurata, shpërblime të ngjashme;

3. SI TË APLIKONI?

Aplikimi i OJQ-ve, Klubeve , Shoqatave si do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i projekt-propozimit
2. Formulari i propozim buxhetit
3. Formulari i deklaratës së partneritetit;
4. Formulari i deklaratës mbi financimin e dyfishtë
5. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
6. Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal;
7. Plani i punës dhe programi së paku për një vit
8. Kopja e Letërnjoftimit;
9. Vërtetimi Bankare.

3.1 Aplikacioni i projekt propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, nuk do të merret në konsideratë.

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

Aplikimi bëhet në formë fizike, në zarfe të mbyllura **në zyrën pritese nr.14 në Komunën e Podujevës.**

Aplikacionet në ndonjë formë tjetër nuk do të pranohen.

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i fundit i thirrjes është dt. 18.09.2020

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen në DKRS, jo më vonë se 8 ditë para skadimit të thirrjes.

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1. Komuna e Podujevës do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve ,që i plotësojnë kushtet për të vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Komuna e Podujevës do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të

thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshëm të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kaloj shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni, Komuna e Podujevës do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, Komuna e Podujevës mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë. Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës 10 ditë, aplikimi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve.

5.LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

FORMULARËT

1. Formulari i projekt-propozimit
2. Formulari i propozim buxhetit
3. Formulari i deklaratës së partneritetit;
4. Formulari i deklaratës mbi financimin e dyfishtë